



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 02/2021 PËR  
AKREDITIMIN E PËRFAQËSUESVE TË MEDIAVE NË  
PRESIDENCË**

Prishtinë, 30.06.2021.



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE**

---

Sekretari i Zyrës së Presidentes,

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 47, 25 janar 2009) dhe nenit 18 të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 02/2021 PËR  
AKREDITIMIN E PËRFAQËSUESVE TË MEDIAVE NË PRESIDENCË**

**KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat për akreditimin e përfaqësuesve të mediave, që përcjellin aktivitetet e Presidentit/es dhe të Presidencës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga:
  - 1.1. njësitë përkatëse në Presidencë;
  - 1.2. mediat dhe punonjësit e medias në profesion të lirë që aplikojnë për akreditim;
  - 1.3. personat të cilët akreditohen.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **President/e**- Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës;
  - 1.2. **Zyra e Presidentit/es** - është njësi e Presidencës dhe institucion i veçantë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës;

- 1.3. **Presidencë** - selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit/es, që përfshin Kabinetin e Presidentit/es, Zyrën e Presidentit/es dhe institucionet/njësitet tjera të ndërlidhura;
- 1.4. **Kabineti i Presidentit/ës** - Njësi e Presidencës e cila përbëhet nga këshilltarët e Presidentit/ës dhe stafi mbështetës;
- 1.5. **Sekretari/e** – Sekretari/ja i/e Zyrës së Presidentit/ës;
- 1.6. **Departament** - Departamenti përkatës për Informim dhe Komunikim me Publikun në Zyrën e Presidentit/ës;
- 1.7. **Media** - nënkupton mediat audiovizive, të shkruara dhe elektronike;
- 1.8. **Përfaqësues të mediave** - çdo person i autorizuar i medias apo punonjësit e medias në profesion të lirë.

## **KAPITULLI II – AKREDITIMI**

### **Neni 4**

#### **E drejta për të aplikuar për akreditim**

Të gjitha mediat, të vendit dhe të huaja, si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë, kanë të drejtë për të aplikuar për akreditim, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ.

### **Neni 5**

#### **Kërkesa për akreditim të mediave**

1. Akreditimi kryhet në bazë të kërkesës së institucionit mediatik pranë se cilës janë të punësuar personat që akreditohen.
2. Kërkesa për akreditim:
  - 2.1. paraqitet me shkrim;
  - 2.2. i drejtohet Departamentit;
  - 2.3. përmban një përshkrim të shkurtër të medias dhe emrat e personave që kërkon të akreditohen;
  - 2.4. përmban kontaktet e medias;
  - 2.5. paraqitet nga personi i autorizuar i medias;
  - 2.6. dorëzohet:
    - i. drejtpërdrejtë në Presidencë;
    - ii. përmes postës, apo
    - iii. në mënyrë elektronike;
  - 2.7. mund të dorëzohet gjatë gjithë vitit;
  - 2.8. mund të tërhiqet në çdo kohë.
3. Kërkesa për akreditim të mediave mund të bëhet në pajtim me Shtojcën 1: Forma e kërkesës për akreditim të mediave, të këtij udhëzimi administrativ.

## **Neni 6**

### **Kërkesa për akreditim e punonjësit të medias në profesion të lirë**

1. Akreditimi kryhet në bazë të kërkesës së vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.
2. Kërkesa për akreditim:
  - 2.1. paraqitet me shkrim;
  - 2.2. i drejtohet Departamentit;
  - 2.3. përmban kontaktet e punonjësit të medias në profesion të lirë;
  - 2.4. dorëzohet:
    - i. drejtpërdrejtë në Presidencë;
    - ii. përmes postës, apo
    - iii. në mënyrë elektronike.
  - 2.5. mund të dorëzohet gjatë gjithë vitit;
  - 2.6. mund të tërhiqet në çdo kohë.
3. Kërkesa për akreditim të punonjësit të medias në profesion të lirë mund të bëhet në pajtim me Shtojcën 2: Forma e kërkesës për akreditimin e punonjësit të medias në profesion të lirë, të këtij udhëzimi administrativ.

## **Neni 7**

### **Dokumentacioni për akreditim**

1. Institucioni mediatik, kërkesës për akreditim, i bashkëngjit këto dokumente:
  - 1.1. certifikatën e regjistrimit;
  - 1.2. listën e personave që kërkohet të akreditohen dhe që përfaqësojnë institucionin mediatik me funksionet përkatëse, ku përfshihet:
    - i. kontaktet e tyre (numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën);
    - ii. adresën e banimit të tyre;
    - iii. periudhën për të cilën kërkohet akreditimi;
    - iv. kopje e dokumentit të identifikimit të personave që kërkohet të akreditohen;
    - v. fotografitë e personave që kërkohet të akreditohen.
2. Punonjësi i medias në profesion të lirë, kërkesës për akreditim, i bashkëngjitë këto dokumente:
  - 2.1. kopjen e dokumentit të identifikimit;
  - 2.2. kontaktet (numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën);
  - 2.3. adresën e banimit;
  - 2.4. periudhën për të cilën kërkohet akreditimi;
  - 2.5. kartelën e gazetarit të lëshuar nga një shoqatë gazetarësh;
  - 2.6. fotografinë e personit që kërkohet të akreditohet.

## **Neni 8 Akreditimi**

1. Akreditimi jepet për:
  - 1.1. gazetarë;
  - 1.2. fotografë (fotoreporter);
  - 1.3. ekipe xhirimi:
    - i. teknikë;
    - ii. operatorë;
    - iii. regjisorë;
    - iv. kameramanë;
    - v. shoferë.

## **Neni 9 Kohëzgjatja e akreditimit**

1. Kohëzgjatja e akreditimi mund të jetë:
  - 1.1. ditorë;
  - 1.2. javorë;
  - 1.3. mujor;
  - 1.4. vjetorë (vit kalendarik);
  - 1.5. për gjithë mandatin e Presidentit/ës.

## **Neni 10 Shqyrtimi i kërkesës për akreditim**

1. Kërkesa për akreditim me dokumentacionin përcjellës shqyrtohet nga Departamenti.
2. Departamenti, në rast se kërkesa dhe dokumentet janë në rregull, përgatit propozimin për akreditim e përfaqësuesve të mediave.
3. Sekretari/ja, me propozimin e Departamentit, aprovon akreditimin e përfaqësuesve të mediave.

## **Neni 11 Kartela e akreditimit**

1. Departamenti, pas akreditimit të përfaqësuesve të mediave dhe punonjësve të medias në profesion të lirë, ju lëshon kartelat e akreditimit.
2. Kartela e akreditimit lëshohet në pajtim me Shtojcën Nr.4: Format e kartelave të akreditimit, të këtij udhëzimi administrativ dhe përmban:
  - 2.1. stemën e Republikës së Kosovës dhe stemën e Presidencës;

- 2.2. mbishkrimin: Republika e Kosovës dhe Presidenca;
- 2.3. emërtimin e institucioni mediatik;
- 2.4. emrin dhe mbiemrin;
- 2.5. funksionin që mban në institucionin mediatik;
- 2.6. fotografën e personit që akreditohet;
- 2.7. numrin e kartelës.
- 2.8. periudhën e akreditimit;
3. Kartela e akreditimit për punonjësit e medias në profesion të lirë përmban:
  - 3.1. stemën e Republikës së Kosovës dhe stemën e Presidencës;
  - 3.2. mbishkrimin: Republika e Kosovës dhe Presidenca;
  - 3.3. emrin dhe mbiemrin;
  - 3.4. funksionin që mban;
  - 3.5. fotografën e personit që akreditohet;
  - 3.6. numrin e kartelës;
  - 3.7. periudhën e akreditimit;
4. Personat e akredituar gjatë qëndrimit në Presidencë mbajnë në vend të dukshëm kartelën e akreditimit.

## **Neni 12**

### **Tërheqja e akreditimit**

1. Sekretari/ja me propozim të Departamentit, pas kërkesës së institucionit të medias apo të punonjësit të medias në profesion të lirë mund të tërheq akreditimin, për personat e akredituar.
2. Sekretari/ja me propozim të Departamentit mund të tërheq akreditimin e personit të akredituar në çdo kohë dhe për këtë duhet të jep arsyetim me shkrim.
3. Në rast të tërheqjes së akreditimit personat janë të obliguar të dorëzojnë kartelën e akreditimit.

## **KAPITULLI III – AKOMODIMI DHE ORIENTIMI**

### **Neni 13**

#### **Kontrolli në hyrje**

1. Personat e akredituar i nënshtrohen rregullave, për hyrje dalje në hapësira të Presidencës.
2. Departamenti dërgon listën e personave të akredituar tek shërbimet përkatëse që merren me kontrollin e hyrje daljeve në Presidencë.

## **Neni 14**

### **Shoqërimi**

Departamenti siguron shoqërim të vazhdueshëm për personat e akredituar gjatë qëndrimit të tyre në Presidencë dhe në hapësirat ku i zhvillohen aktivitetet e Presidencës.

## **Neni 15**

### **Akomodimi**

Departamenti kujdeset që personat e akredituar në Presidencë të akomodohen në hapësirat e caktuara për ta dhe të ndihmojë në krijimin e kushteve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre.

## **Neni 16**

### **Komunikimi me përfaqësues të mediave**

Presidenca siguron komunikim të vazhdueshëm me personat e akredituar dhe të njëjtit i informon në kohë dhe me transparencë për veprimtarin e Presidencës.

## **Neni 17**

### **Organizimi i intervistave**

1. Organizimi i intervistave me Presidentin/ën zhvillohet në bazë të kërkesës së përfaqësuesit të medias, të paraqitur në Departament apo Kabinet.
2. Kërkesa duhet të përmbajë:
  - 2.1. çështjet konkrete për të cilën kërkohet të zhvillohet intervista;
  - 2.2. datën, orën dhe vendin e caktuar kur planifikohet të zhvillohet intervista.
3. Departamenti, në bashkëpunim me Kabinetin, shqyrton kërkesën për intervistë, dhe kthen përgjigje.

## **Neni 18**

### **Organizimi i konferencave për shtyp**

1. Konferenca për shtyp organizohet nga Presidenca në hapësirën e caktuar, ku paraprakisht ftohen përfaqësuesit e mediave.
2. Personat e akredituar, me kërkesën e tyre, mund të marrin kopje të deklaratës nga konferenca.

## **KAPITULLI IV - SJELLJA**

### **Neni 19 Mbajtja e rendit**

1. Zyrтари i Departamentit paraprakisht i njofton personat e akredituar për mënyrën e sjelljes dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë, gjatë kohës sa ndodhën në hapësirat e Presidencës.
2. Personat e akredituar, gjatë kohës sa ndodhën në hapësirat e Presidencës, detyrohen t'i përmbahen rendit dhe rregullave të sjelljes në Presidencë.
3. Nëse ndonjëri/a nga personat e akredituar nuk i përmbahet rendit dhe rregullave të sjelljes në Presidencë, Departamenti, nëse e vlerëson si të nevojshme, mund të largojë nga ndërtesa personin e caktuar që bën shkeljen.

### **Neni 20 Paraqitja e personave të akredituar**

Personat e akredituar në Presidencë, gjatë zhvillimit të konferencave, intervistave apo ngjarjeve të caktuara, paraqiten me veshje serioze.

### **Neni 21 Masat**

1. Departamenti në rast të shkeljes së rendit, nga personi i akredituar, tërheq akreditimin në mënyrë të arsyetuar dhe ia merr kartelën e akreditimit.
2. Për veprimin nga pika 1 e këtij Vendimi, njoftohet Shërbimi i Sigurisë në Presidencë dhe institucioni mediatik përkatës.

## **KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 22 Regjistri i personave të akredituar**

1. Departamenti mban dhe përditëson regjistër elektronik për personat e akredituar.
2. Regjistri përmban:
  - 2.1. mediat e akredituara, ku përfshihen të dhënat:
    - 2.1.1. përfaqësuesit e tyre;
    - 2.1.2. kohën e akreditimit;
    - 2.1.3. kontaktet e nevojshme.
  - 2.2. Të dhënat për punonjësit e medias në profesion të lirë të akredituar:
    - 2.2.1. kohën e akreditimit;
    - 2.2.2. kontaktet e nevojshme.



3. Drejtori i Departamentit cakton zyrtarin/en e Departamentit, i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit.

### **Neni 23**

#### **Shtojcat**

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur këtij udhëzimi administrativ janë pjesë përbërëse e tij:
  - 1.1. Shtojca 1: Forma e kërkesës për akreditim të mediave;
  - 1.2. Shtojca 2: Forma e kërkesës për akreditim të punonjësit të medias në profesion të lirë;
  - 1.3. Shtojca 3: Forma e Regjistrit të personave të akredituar;
  - 1.4. Shtojca 4: Format e kartelave të akreditimit.

### **Neni 24**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**Fehmi MEHMETI**

---

**u.d. Sekretar i Zyrës së Presidentes**

Prishtinë, 30.06.2021.

*Shtojca Nr. 1: Kërkesa për akreditim të mediave*



**REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENCA**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - PRESIDENCY**  
**REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNIŠTVO**

Emërtimi i medias	
Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar të medias	
Adresa e medias	
Numri i telefonit:	
E-maili	
<b>DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:</b> <b>(Shënoni me X ato që keni dhe bashkëngjitni në aplikacion)</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>➤ kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar të medias <input type="checkbox"/></li><li>➤ një përshkrim i shkurtër i medias <input type="checkbox"/></li><li>➤ certifikata e regjistrimit të medias; <input type="checkbox"/></li><li>➤ lista e personave që kërkohet të akreditohen dhe që përfaqësojnë institucionin mediatik me funksionet përkatëse, ku përfshihet:<ul style="list-style-type: none"><li>• kontaktet e tyre (numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën); <input type="checkbox"/></li><li>• adresën e plotë të banimit të tyre; <input type="checkbox"/></li><li>• periudhën për të cilën kërkohet akreditimi; <input type="checkbox"/></li><li>• kopje e dokumentit të identifikimit të personave që kërkohet të akreditohen; <input type="checkbox"/></li><li>• fotografit e personave që kërkohet të akreditohen. <input type="checkbox"/></li></ul></li></ul>	
<b>Nëse e keni ndonjë dokument shtesë, e që e mbështetë deklaratën tuaj cekni dhe bashkëngjitni:</b>	

**DEKLARATË PERSONALE**

Unë, (emri, mbiemri) \_\_\_\_\_

**DEKLAROJË SE:** Të gjitha informacionet e dhëna dhe të bashkëngjitura janë të sakta

- **VËREJTJE:** *Deklarata dhe prezantimi i të dhënave si dhe dëshmime të rrejshme me qëllim të përfitimit të të drejtave ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi!*

Nënshkrimi: .....

Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

*Shtojca Nr. 2: Kërkesa për akreditim e medias në profesion të lirë*



**REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENCA**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - PRESIDENCY**  
**REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNIŠTVO**

Emri dhe mbiemri i punonjësit të medias në profesion të lirë	
Adresa e personit	
Numri i telefonit:	
E-maili	
<b>DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:</b> <b>(Shënoni me X ato që keni dhe bashkëngjitni në aplikacion)</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>➤ kopja e letërnjoftimit të punonjësit të medias në profesion të lirë <input type="checkbox"/></li><li>➤ periudha për të cilën kërkohet akreditimi; <input type="checkbox"/></li><li>➤ kartela e gazetarit të lëshuar nga një shoqatë gazetarësh e njohur ligjërisht; <input type="checkbox"/></li><li>➤ fotografi e personit që kërkohet të akreditohet. <input type="checkbox"/></li></ul>	
<b>Nëse e keni ndonjë dokument shtesë, e që e mbështetë deklaratën tuaj cekni dhe bashkëngjitni:</b>	

**DEKLARATË PERSONALE**

Unë, (emri, mbiemri) \_\_\_\_\_

**DEKLAROJË SE:**

Të gjitha informacionet e dhëna dhe të bashkëngjitura janë të sakta

- **VËREJTJE:**
- *Deklarata dhe prezantimi i të dhënave si dhe dëshmime të rrejshme me qëllim të përfitimit të të drejtave ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi!*

Nënshkrimi: .....

Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

*Shtojca Nr. 3: Regjistri i personave të akredituar*



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSIEDNICE**

DEPARTAMENTI I INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN  
DEPARTMENT OF INFORMATION AND PUBLIC COMMUNICATION  
ODELJENJE ZA INFORMISANJE I KOMUNIKACIJU SA JAVNOŠĆU

---

## **REGJISTRI I PËRFAQËSUESVE TË MEDIAVE TË AKREDITUAR**

Përditësuar më \_\_. \_\_. \_\_\_\_

Përditësuar nga: \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE**




DEPARTAMENTI I INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN  
DEPARTMENT OF INFORMATION AND PUBLIC COMMUNICATION  
ODELJENJE ZA INFORMISANJE I KOMUNIKACIJU SA JAVNOŠĆU

---




<b>MEDIAT E AKREDITUARA</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Emri i medias</b>	<b>Përfaqësuesit e medias dhe funksionin që mban</b>	<b>Periudha e akreditimit</b>	<b>Kontaktet e medias dhe përfaqësuesit</b>
1.				
2.				
3.				
<b>PUNONJËSIT E MEDIAS NË PROFESION TË LIRË TË AKREDITUAR</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe mbiemri i punonjësit</b>	<b>Funksioni që mban</b>	<b>Periudha e akreditimit</b>	<b>Kontaktet e punonjësit</b>
1.				
2.				
3.				

*Shtojca Nr.4: Format e kartelave të akreditimit*

*Kartela për personat e autorizuar të medias*

	
Republika e Kosovës - Presidenca	
<b>EMRI I MEDIAS</b>	
EMRI	
MBIEMRI	
Pozita	
Nr. ID:	
Vlen deri me:	
<b>AKREDITIM</b>	

*Kartela për personat e autorizuar të medias në profesion të lirë*

	
Republika e Kosovës - Presidenca	
EMRI	
MBIEMRI	
Pozita	
Nr. ID:	
Vlen deri me:	
<b>AKREDITIM</b>	